



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së nëntë-IX të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 31.08.2023 ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komitete, Remzi Shala, Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Durim Hajra, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Hasime Kostanica, Doruntina Jashari, Mirsad Qyqalla, Dardane Sogojeva Shala, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Arbnore Kelmendi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Ramadan Jashanica - Drejtor për Financa dhe Buxhet, Maliq Berisha - Drejtor për Shërbime Publike e Mjedis, Mimoza Kolshi - Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë, Arbër Statovci - Drejtor për Inspektorat dhe Bardhyl Koçiçi - Drejtor për Infrastrukturë.

Të tjerë: Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetë të pranishmit në mbledhje dhe pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 22.06.2023, 26.06.2023 dhe 26.07.2023.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për norma të reja në Arsim.
4. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024.
5. Propozim për shqyrtimin e dytë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027.
6. Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Subvencione.
7. Rishqyrtimi i vendimit me Nr. 137, të datës 07.06.2023.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas leximit të pikave të rendit të ditës e hapi diskutimin.

Durim Hajra: Përshendetje për të pranishmit në mbledhje, dhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, ka ardh një propozim kërkoj nga kryesuesi të njoftohen anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani unë dua të ju njoftoi se mbledhja është duke u ingjizuar tani nga z. Arlind Imeri, i cili e ka hapur një medium të regjistruar në ARBK në nivel nacional, por do të mirret veçanërisht edhe me tema lokale të Komunës së Fushë-Kosovës, kjo mbledhje është duke shkuar live, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale mbledhja e Kuvendit të Komunës është e hapur, vetëm se duhet të identifikohet secili pjesëmarrës në mbledhje. Po ashtu dua të ju sqaroj se në mbledhjen e jashtëzakonshme të muajit korrik, ju kam thënë unë këtu, se mund ta mbajmë një mbledhje në fund të muajit gusht, apo në fillim të muajit shtator. Lidhur me propozimin e tatimit në pronë, jemi dakorduar me kërkesën e Nënkryetarit të Komunës, se kjo punë do të analizohet në aspektin e implikimeve buxhetore dhe ndikimit të saj në projekte kapitale, pas analizimit të gjendjes mund të shqyrtohet në Kuvendin e Komunës, andaj lidhur me këtë çështje e kemi patur një dakordim të Shefave të Grupeve Parlamentare në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një propozim që vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 180, i datës 29.12.2020 lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për personat e prekur nga Covid - 19, ku vendim nuk është zbatuar andaj kërkojmë, ose të zbatohet ose të shfuqizohet, sepse për punën në kohën e pandemisë është kompensuar Shtabi Emergjentë Komunal, një pjesë e tyre në vitin 2020, ndërsa pjesa e mbetur e punëtorëve tani këtë vitë nëpërmjet përmbaruesit privat, ku dymbëdhjetë punëtorëve të punësuar në kuadër të Projektit të Karitasit, paligjshëm ju është ndërruar vendi i punës nga kontrata që e kanë patur sipas projektit për të fituar të drejtën e kompensimit, ata nga punëtorët e shërbimeve publike janë shndërruar në zyrtar administrativ, po ashtu këtu mjete financiare i kanë përfituar atëherë edhe Ish/ Nënkryetari i Komunës, Drejtor të Drejtorateve Komunale dhe punëtorë të komunës.

Vlonjat Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoi që materialet fizike për mbledhje që na janë dërguar më herët në shtëpi, tani të na vendosen në tavolina së paku ditën e mbledhjes, e pranojmë se deri tani kush ka dashur ka mundur t'i marrë kopjet fizike vetë në Shërbimin e Kuvendit.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qesim në votim rendin e ditës së propozuar.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës e aprovon për shqyrtim me unanimitet të votave rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 22.06.2023, 26.06.2023 dhe 26.07.2023.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani i kemi për shqyrtim dhe aprovim ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të datës 22.06.2023, 26.06.2023 dhe 26.07.2023, hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet e juaja.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoi që të përmirësohet diskutimi im në faqën numër gjashtë, të mbledhjes së muajit qershor kur kanë hyrë policët në Sallën e Kuvendit të Komunës, unë nuk kam thënë se sms-ja ka ardhur nga dikush prej anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, sikur është evidentuar në esktakt të procesverbalit, por kam thënë se është lajmëruar dikush me një sms, kinse

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e ka kërcnuar për pjesëmarrje në votim, pastaj në fund të mbledhjes ka ardhur Policia e Kosovës.

Durim Hajra: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, ne jemi kundër aprovimit të ekstraktit të procesverbalit nga mbledhjet e kaluara të Kuvendit të Komunës, meqë nga ana e Ekzekutivit të Komunës, nuk po lejohet të bëhet publikimi i audioincizimeve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mirsad Qyqalla: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, edhe ne jemi kundër aprovimit të ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara të Kuvendit të Komunës, sepse nga ana e Ekzekutivit të Komunës, nuk po lejohet të bëhet publikimi i audioincizimeve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhja e kaluar të Kuvendit të Komunës, të mbajtura me datën 22.06.2023, 26.06.2023 dhe 26.07.2023, me përmirësimin e cekur nga diskutimi i anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', nëntë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovon ekstraktin e procesverbalit nga mbledhjet e kaluar e Kuvendit të Komunës, të mbajtur me datën 22.06.2023, 26.06.2023 dhe 26.07.2023, me përmirësimin e cekur nga diskutimi i anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrojnë ndonjë pyetje nëse kanë për Ekzekutivin e Komunës.

Durim Hajra: Po filloj me pyetjen për Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku dihet se Klubi i Futbollit 'Fushë-Kosova', është në Super ligë dhe është pritë që ka me shkua në Super ligë, që ka qenë edhe premtim i Kryetarit të Komunës, ku edhe një pjesë e konsiderueshme e votave ka arrit me i sigurua, mirëpo premtimin nuk e ka mbajtur dhe lojtarët e Komunës së Fushë Kosovës në mungesë të infrastrukturës janë të detyruar me i zhvilluar ndeshjet në një komunë fqinje. Drejtor pres një përgjigje prej teje ashtu siç presin shumë vendas e lojtar që t'i zhvillojnë ndeshjet në Fushë-Kosovë, kur keni me bërë këtë investim të madh, i cili para fushatës ka qenë krye temë. Një pyetje tjetër drejtor, keni premtuar se keni me bërë një monitorim të subvencioneve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pyetja ime është se a keni nxjerrë një raport se a janë shpenzuar ato mjete financiare për çka janë ndarë, edhe sa prej atyre projekteve janë implementuar? Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, besoj që drejtori ka nis me u ambientua, se ka qenë me përvojë sidomos me nivelin lokal, mirëpo ndoshta ka përvojë edhe në Drejtorin e Arsimit, nuk jam i sigurtë, po ashtu një pyetje prej prindërve, është se a keni pas koordinim me Këshillin e prindërve dhe nxënësve kur është bërë ndarja e nxënësve, sidomos në pjesën e qytetit, ku punohet me tri ndërrime, nëse po a janë marrë parasysh, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, sepse në kohën e dimrit me mbet fëmijët deri në ora shtatë pas dite është shumë shqetësuese. Pyetja tjetër është, a janë duke u

monitoruar këto renovime nëpër shkolla, nëse po atëherë, a keni nxjerrë ndonjë raport, sepse nuk janë duke u krye punimet siç duhet. Kam tri pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, kam ngrit edhe disa herë çështjen e rrugës 'Aziz Zhilivoda', e cila është një rrugë mjaftë e frekuentuar prej nxënësve dhe kam kërkesa nga prindërit që t'i vendosni disa pengesa, nuk e di se ku është problemi, pse nuk po vendosen, këtë shqetësim e kemi ngritë, për katër vite radhazi, edhe pse po rrezikohen nxënësit çdo ditë prapë, nuk janë duke u vendosur këto pengesa, ku nuk është ndonjë investim i madh kapital aty. Pyetja e dytë është, pse nuk po sanohen këto dëmet në rrugën 'Hajrullah Zymi', kjo është rruga më e frekuentuar dhe rruga më problematike, ka vështirësi në qarkullim, sepse nuk kryhen punët siç duhet. Pyetjen e tretë për këtë Drejtori e kam, a keni paraparë që të ndërtohet rruga 'Vëllezërit Gërvalla', sepse banorët kanë bërë edhe kërkesë zyrtarisht dhe e di se kanë marrë pjesë në vitet e kaluara në dëgjimet buxhetore, mirëpo nuk kanë marrë ndonjë përgjigje, për mu ndërtua ajo rrugë. Nuk po e shofë këtu Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, mirëpo unë po e parashtroi pyetjen, ka të bëjë me ndriçimin publik, ku më kanë shkruar pesëmbëdhjetë qytetarë, prej kur kam publikuar mbledhjen, kjo ka qenë një kërkesë më e veçantë, aty ku një gazetar jeton në rrugën këtu jo larg komunës, të cilit ju ka sulmuar shtëpia, i cili është kontaktua nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, në kohën kur ju ka sulmuar shtëpia dhe i kanë ofruar ndihmë dhe e vetmja kërkesë, që e ka pasur qytetari, është që me u bërë ndriçimi në rrugë, por nuk është bërë, qytetari prapë kishte pasur një problem në rrugë dhe si mungesë e ndriçimit publik, policia nuk ka mundur me përfundua punën për shkak të ndriçimit publik, sepse nuk ka pamje të qarta. Një çështje tjetër që u ri aktualizua dhe e kemi ngrit, edhe më herët në Kuvend, është çështja e një investimi, që e ka bërë Komuna e Fushë-Kosovës në shumën e mjeteve financiare prej: 20,000.00€, për Komunën e Suharekës, që ka të bëjë me një vendim të vitit 2018. Me çfarë vendimi janë ndarë ato mjete financiare, në qoftë se ka pas vendim, sepse është bërë temë, sepse kjo vlerë është e taksave të qytetarëve dhe këtu është bërë një shkelje e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Buxhet dhe Financa, mendoi që duhet me dal para përgjegjësisë, ata të cilët e kanë shkel ligjin dhe besoj, që policia dhe hetuesia, duhet me u marrë, me këtë çështje pasi që u ri aktivizua.

Mirsad Qyqalla: Tani do ta paraqesim një pyetje që këtu është bërë e zakonshme, për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit, por tani këtu është edhe Nënkryetari i Komunës, i cili e përfaqëson këtu Kryetarin e Komunës, pyetja ka të bëjë me mosfunksionimin e ndriçimit publikë në pjesën më të madhe të territorit të komunës, përgjigjja e zakonshme është, se kemi të bëjmë me një kontraktorë të pa ndërgjegjshëm, por tani është nënshkruar një kontratë e re dhe nuk kemi përmirësim të gjendjes në teren, ku 60 deri 70% e tyre janë jashtë funksionit, janë jashtë funksionit rruga 'Dituria', 'Çlirimi', pastaj kryqëzimi te shkolla 'Mihal Grameno', tek shkolla 'Aneksi 1', njësoi është gjendja edhe në fshatrat tjera, në fshatin Bardh i Madh, shumica e dritave nuk funksionojnë fare. Rruga 'Xhemajl Mustafa' në Fushë-Kosovë, është vendosur të jetë si pilot-projekt për rrugë një kahore, është vendosur të jetë si matje, por nuk po funksionon, mirëpo ne nuk e kemi një informatë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit për këtë punë, aty Policia e Kosovës është inekzistente. Tani është në proces 'Mbulimi i gropave nëpër rrugë', ku

kontrata është ndërprerë, këto gropa kanë filluar të mbulohen me zhavor dhe beton, por para ngrirjes së tij, aty kalojnë automjetet dhe këto vende dëmtohen shumë, një gjendje e tillë po thuaj se është në secilën rrugë. Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, e kam një pyetje lidhur me ndarjen e ndihmave momentale për studentët e komunës tonë, ne kërkojmë që kjo ndarje të jetë e drejtë dhe përfitues të jenë studentët e komunës tonë, e jo kjo të bëhet sipas tekeve të zyrtarëve të komunës, të cilët nuk japin kurrfarë sqarimi, unë e kam një rastë për të cilin do ta informoi Drejtorin e Arsimit. Po ashtu një ditë para fillimit të vitit të ri shkollorë, banjot në shkollën 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë, janë jashtë funksionit, njësoi është gjendja edhe në shkollën 'Zenel Salihu' në fshatin Bardh i Madh, për menaxhimin e kontratës është një menaxher i saj, andaj kërkojmë që të kërkon llogari për kryerjen si duhet të punimeve në shkollat tona, buxheti ka qenë i planifikuar punimet është dashur të fillojnë me kohë, e jo të shtyhet procesi mësimorë, sepse nxënësit tonë po pësojnë dhe zëvendësimi i mësimit nuk është efektiv fare, këtë e tregon praktika e vitit të kaluar shkollorë, që është e ditur për të gjithë ne. Unë nuk jam në njohuri se një kompani e papërgjegjshme është futur ndonjëherë në listën e zezë nga Komuna e Fushë-Kosovës. Shqetësim tjetër është edhe orari i mësimit i caktuar me një vendim të komunës, ku nxënësit do të përfundojnë procesin mësimorë në orën 18.40 minuta dhe do të udhëtojnë në relacione të largëta, edhe brenda qytetit tonë, andaj propozoi që të shikohen mundësitë për ndryshimin apo modifikimin e tij, sepse në stinën e dimrit ky orarë është i mësimit për nxënësit e komunës tonë, është i papërshtatshëm.

Hasan Ismajli: Unë pyetjet që do t'i paraqes tani këtu, i kam paraqitur edhe me shkrim para katër ditëve, por nuk e kam asnjë përgjigje, ato tani do t'i lexoi, pyetja e parë është për Drejtorin e Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, sa prona komunale i kemi përfituar ne, nga dhënia e bonuseve të zonimit për ndërtime në qytetin e Fushë-Kosovës, unë i kam ato t'i dërgoi, në atë, se a janë të ligjshme apo të paligjshme këto, pra dhënia e bonuseve nuk hy, sepse ju nuk i jepni ata si Drejtori Komunale, por duhet të keni informata për pronat e fituara nga kompenzimi. Për Nënkryetarin e Komunës, të cilit i dëshirojmë suksese në punë, e kam një pyetje për numrin e madh të punëtorëve të Projektit të Karitasit, të cilëve pa asnjë vendim ju është ndërruar vendi i punës, edhe për të përfituar më herët kompenzimin për punën në kohën e pandemisë, po ashtu disa prej tyre japin mësim në shkollë, ku notat e vendosura prej këtyre mësimdhënësve janë të pavlefshme, do t'i marrin në qafë nxënësit, ne kërkojmë ta dijmë, se sa është numri i këtyrë punëtorëve si mësimdhënës dhe në bazë të cilit kriter, për zgjidhen këtë për të dhënë mësim në një shkollë. Po ashtu e kam një pyetje edhe për përgjegjësin e Drejtorisë së Planifikimit Urban z. Parayll Zogianin, sepse penzioneri Drerejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, kohën e tij të lirë e kalon në zyre dhe nuk jep kurrfarë llogarie, sa oborre private janë shtruar nga viti 2021-2023 nga Drejtoria e juaj, unë këto asfaltimi i kam edhe me fotografi, por e kërkoi një përgjigje zyrtare nga Drejtoria e Urbanizmit. Cili është arsye e vizitës në Turqi tek komuna e vllaznime me komunën tonë, por Drejtori i Drejtorisë së Administratës nuk është këtu sot, sepse është i zënë me punë, andaj e kërkoi një përgjigje nga Drejtori i Infrastrukturës, i cili është prezentë këtu, meqë edhe ku udhëton. Në shëndetësi, lobaratori nuk punon, por nuk ka as interesimin më të vogël për rregullimin e tij, po ashtu nga ndarja e subvencioneve në shëndetësi ku aty është

interesimi, tani kanë mbajtur një mbledhje të Komisionit dhe kanë kaluar vetëm katër kërkesa, njëra 1,400.00E, njëra 400.00E dhe dy tjera nga një mijë euro, ku kemi edhe kërkesa të kolegëve tonë që janë aprovuar, unë kam kërkuar që të ndihmohen edhe dy raste të personave të verbër, ku njëri është fëmijë i familjes Xheladini me origjinë nga Medvegja, unë pyes, pse nuk ka kaluar rasti i këtij fëmijë.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e uroi Nënkyetarin e Komunës për pozitën e re dhe atij i dëshirojmë punë të mbarë dhe suksese, kërkojmë që të ushtron ndikimin e tij dhe të na rregullon kushtet e punës në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar së pari nga rregullimi i mikrofonave. Shqetësimi i yni është problemi me shtyllat elektrike në lagjet e urbanizuara, një rrezik i tillë është në rrugën 'Tahir Sinani', ku ka rënë shtylla në rrugën time dhe paraqet rrezik për njerëzit. Ne këtu në parim jemi për rritjen e normave të reja në arsim, por këtu duhet të punohet nga Drejtorët e shkollave dhe komuna, për rregullimin e punës, për mos regjistrimin e nxënësve të banorëve jorezidente, kjo punë neve po na shkakton shumë probleme në arsim, shëndetësi dhe administratën e komunës, ku shërbimet që ofrohen rriten në numër dhe ne personelin tonë, nuk mund ta rrisim për arsye të formulave të përcaktimit të buxhetit të komunës, për këtë fakt tani na janë shtuar edhe ndërrimet në arsim. Në lokacionin te Stadiumi i qytetit, janë disa lokale ku zhvillohet dukuri negative dhe prostitucion, këtë çështje e kam paraqitur disa herë dhe asnjëherë deri tani nuk janë marrë masa konkrete, nga Inspektorati i Komunës.

Qëndresa Ademi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, duke pas parasysh faktin se kemi një numër të madh problemesh në lagjet tona dhe sa u përket rrugëve dhe nën-rrugëve, të cilat janë në gjendje të mjerueshme dhe të pa asfaltuara dhe nisur nga fakti se asfaltimi i rrugëve, veç sa ka filluar nëpër disa fshatra të Fushë-Kosovës. Pyetja ime është çka do të ndërmerrni për lagjet tona, lidhur me asfaltimin e këtyre rrugëve, pasi që ka qenë kërkesë e mëhershme, qoftë nga ana e qytetarëve dhe nga ana ime si asambleiste, për verifikimin e punëve dhe asfaltimin e 'lagjeve 028 dhe 029'. Problemin tjetër e kemi me qentë endacak, që po paraqesin rrezik permanent, ku qytetarët dhe nënat shprehin shqetësimin e tyre për fëmijët e tyre, që po rrezikohen çdo ditë nga ata qentë. Pyetja ime është se a keni gjetur ndonjë zgjidhje, sa i përket këtij shqetësimi dhe rreziku. Meqenëse tashmë po fillojmë edhe me pregaditjen e fëmijëve në shkollë, pyetja është bërë se a kanë planifikuar për të organizuar ndonjë transport së paku, që ky transport t'iu organizohet klasave të para deri në klasat e treta. Problem tjetër është ndriçimi publik i cili nuk funksionon në lagje, shqetësimin tjetër banorët e lagjes e kanë sa i përket shëndetësisë, ku në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, ka shumë thirrje emergjente për ndihmë, por fatkeqësisht ka mungesë të ambulancave. Pa e harruar edhe Nënkyetarin tonë të Komuniteteve, pyetja është se a'po të pengon qeni i ngordhur, më shumë se një muaj tek rruga kalimtare, tek stacioni hekurudhor, pasi që ajo rrugë është e vetme që njerëzit e shfrytëzojnë për të kaluar, e për të shkuar në punë, shkollë e tjera. Ndërsa për kolegun dhe njëherit Zëvendës Kryesuesin e Kuvendit të Komunës për Komunitete, e pyeta se apo e shqetësojnë atë të gjitha këto shqetësime dhe probleme që unë i ngrita, e që vazhdimisht për dy vite radhazi po i ngris dhe për të cilat nuk ka, as edhe ndonjë zgjidhje të vetme edhe pasi që është bërë Nënkyetar i Komunës për Komunitete, e me akuzat e tij po i dukem kukull

në asamble. Në aspektin që nuk bëjnë asgjë unë pyes se çfarë keni bërë ju në lidhje me këto shqetësime që po përballen lagjet 028 dhe 029. Sa i përket fushës sportive të gjithë i kemi grryer dhëmbët nga pak që kjo fushë t'u realizohet të rinjëve tanë, sa më shpejt që të jetë e mundshme. Të nderuar unë nuk merrem me askënd, por në qoftëse duhet dhënë llogari para popullit, mos të harrojmë se ka dikush që ka dy herë më shumë përgjegjësi për popullin.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sigurimi i shkollave duhet të bëhet në bashkëpunim me policinë, ku nxënësve pas kontrollit në shkollë u janë gjetur armë të ftohta dhe lëndë narkotike, po ashtu çështje tjetër të cilën duhet të ngriti tani këtu janë, lejet për parkingje para lokaleve, ku qytetarët kanë telashe me pronarë të lokaleve. Kërkojmë që në Qendrën e Mjekësisë Familjare në lagjen e Dardanisë, duhet të punohet njëzet e katër orë. Për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, unë me profesion jam inxhinere e komunikacionit, rrugët e caktuara si një kahore kanë shkaktuar bllokim në komunikacion, po ashtu ka patur edhe aksidente, ku vajza ime është goditur nga makina natën e Bajramit tek shkolla 'Aneksi 1', andaj gjendjen afër shkollave 'Mihal Grameno' dhe 'Aneksi 1' dhe 'Aneksi 2', duhet të ketë një kontroll më të madhe nga Inspektorati i Komunës, në kohën e lëvizjes së madhe të nxënësve.

Shpend Bardiqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Stadiumi i futbollit në fshatin Miradi e Poshtme, është pastruar ngë një grup i qytetarëve vullnetar, aty i zhvillon aktivitetet me fëmijë një Klub i Atletikës, këtu duhet të përfshihet edhe komuna dhe të bënë rregullimin e kësaj fushe. Qentë endacakë dhe ndriçimi publikë në komunën tonë janë probleme që nuk janë zgjidhur asnjëherë nga komuna deri tani, në shumë shtylla dritat nuk janë të ndezura fare. Mungesa e parkingjeve në zonën e qytetit nuk është trajtuar, as me Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, për hartimin e të cilit janë shpenzuar dy qindë mijë euro dhe janë vënë në funksion dy rrugë një kahore, pa trotuar dhe pa parkingje askund. Banorët e Nën Hekurdhës kërkojnë mbulimin e gropave në rrugë, pastrimi i rrugëve tona mungon dhe ne jemi, ndër qytetet me pa pastërtinë më të madhe, ku ne jemi qyteti më i ndotur në Kosovë. Transparenca është e ngjajshme me komunat veriore të vendit Zveçanin dhe Leposaviqin, ku Kryetari i Komunës është i ngjuar atje, ku veprojnë shumë kriminel, ne jemi komunë e hapur por mungon transparenca për punët e komunës. Lidhur me tenderin për vendosjen e kamerave janë shpenzuar mijëra euro, ku një kamerë kushton deri në 1,600.00€, kam informata se ka kamerë që kushton edhe deri në gjashtë mijë euro, pyetja ime tani është a flasin këto kamera, sepse kemi informata se pronarin e kompanisë e njeh Nënkryetari i Komunës dhe kanë punuar së bashku më herët.

Vlonjat Hasani: Përshëndetje për të gjithë kolegët asambleistë, unë i kam disa pyetje për disa drejtor të drejtorive. Meqenëse edhe nënkryetari i ri i Komunës, qenka prezent sepse ende nuk kemi pasur mundësi që të ulemi dhe të bisedojmë me të, po kam dëshirë që ta njoftoj për kërkesat dhe shqetësimet që i kanë qytetarët e Komunës sonë po filloj me problemin e rrugës 'Lumi' në fshatin Miradi e Epërme, ku tash e dy vite ata kanë probleme me kanalizimin rreth 200 shtëpi të kësaj lagje dhe ende nuk keni bërë as iniciativën më të vogël për zgjedhjen e këtij problemi në fshatin Miradi e Epërme, andaj ne do të vazhdojmë të bëjmë këtë pyetje deri në rregullimin dhe finalizimin e këtij problemi, që e kanë banorët e fshatit Miradi e Epërme, po ashtu kemi shqetësime nga qytetarët edhe tek nënkalimi i

shkollës 'Daut Bogujevci', i cili nuk po mirëmbahet dhe i kemi parë, edhe reagimet e qytetarëve dhe po presim që Ekzekutivi i Komunës, të merret me këtë problematikë për mirëmbajtjen e nënkalimit. Pyetjen tjetër dua që ta parashtroj për Drejtorin e Arsimit, si është e mundur që dy javë para se të filloj procesi mësimor të fillon renovimi i shkollave dhe këto renovime siç po shihet nuk do të arrijnë, që të përfundojnë me kohë, sepse procesi mësimor do të filloj nesër, me këtë menaxhim tuajin besoj se nxënësit, do të humbin shumë dhe shihet se cilësia e renovimit në objektet shkollë është shumë e dobët. Për punën e librave i nderuari drejtor do të flasim kur të duash dhe do të replikojmë këtu në sallë pa asnjë problem, sepse qeveria është duke e rregulluar këtë çështje. Konkursët në arsim të cilat kanë qenë të shpallura nuk e di, se a jeni konsultuar me zyrtarët ligjore dhe zyrën ligjore, sepse brenda ditës keni anuluar konkurse dhe pas tri ore e keni shpallur të njëjtin konkurs, nuk e di a jeni në dijeni se çka jeni duke vepruar, nuk e di, a keni të drejtë apo s'keni veç në fund do të penalizoheni ju i nderuari drejtor. Tash dua ta parashtroj një pyetje për Ekzekutivin e Komunës e në veçanti për Nënkryetarin e Komunës, edhe pse e di se Nënkryetari i Komunës vonë ka ardhur në Komunën e Fushë-Kosovës. Ju nuk e keni parashtruar asnjë kërkesë tek Ministria e Infrastrukturës për mbështetjen e ndonjë projekti publikë, cili do qoftë ai, sepse sipas konstatimeve nga kjo ministri asnjëherë nuk është bërë ndonjë kërkesë zyrtare nga Komuna e Fushë-Kosovës për mbështetjen e projekteve kapitale. Kjo punë i bjen se Komuna e Fushë-Kosovës për mbështetje nga ana e Qeverisë në aspektin e infrastrukturës, sepse është jo e mirë që deri më sot, a tentoni të bëni kërkesë. Pyetjen tjetër të cilën e përmendi edhe kolegu im z. Shpendi, problemin me rrugë unë po i'a shtoj vetëm një nën pyetje, pyetjes së tij, sa ka kushtuar ngjyrosja e gropave edhe në pjesë ku ecin këmbësorët, nëpër vendkalimet e kudo nëpër qytet dhe fshatra, sepse ne kemi parë që gropat nëpër vendkalime janë ngjyrosur dhe pyetja ime është, sa është vlere e ngjyrosjes së gropave në vendin tonë. Tek rruga '17 Shkurti', kemi një problem nga kompanitë e taksive që po e bllokojnë dhe po e vështirësojnë qarkullimin e automjeteve. Jemi në dijeni se kanë dalë inspeksioni në rrugë për largimin e taksive ilegal, mirëpo duhet që të dalin vazhdimisht e jo vetëm njëherë, sepse kjo kompani është duke vazhduar prapë, pyetja ime është, apo keni frikë me u marrë me kompanitë e taksive apo ata janë më të fuqishëm se ju dhe ju nuk pyetni fare dhe ata e uzurpojnë hapësirën e rrugës po flas në të dy anët e rrugës dhe vetëm një veturë aty nuk mund të kalojë, kur parkohet kompania e taksive dhe kjo çështje duhet të rregullohet. Pyetjen tjetër e kam për Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të cilin nuk po e shoh sa aktivitete i keni mbajtur, sepse unë vetëm një turnir e kam parë në shkollën 'Mihal Grameno', asnjë aktivitet tjetër nuk e kanë mbajtur, as 50% të atyre zotimeve që i ka thënë drejtori vet, drejtori ka fol se në kohën kur do të jetë mërgata në korrik dhe gusht. Për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, a keni ndërmarrë diçka për zhurmën që e krijojnë kompanitë e ndërtimit, ku me kamionët e tyre kalojnë në rrugët e qytetit dhe banorët e kanë të pamundur të flejnë rehat qytetarët, ata kanë tentuar që të mirren me Drejtorinë e Inspektoriatit dhe me Policinë e Kosovës, mirëpo nuk ka dal ndonjë dorë që mundet me i ndal këto kompani të ndërtimit, te cilat po shkaktojnë probleme të një pas njëshme tek qytetarët, kështu që po ju lutem, që të mirremi me këtë problematikë, sepse mua më kanë thënë disa qytetarë do të dalim dhe do ta bllokojmë rrugën, që ta ndalim dhe ta zgjedhim

këtë problem, sepse nuk po mundemi as gjumin ta bëjmë rehat nëpër shtëpitë tona, mendoj se kishte qenë mirë me i parapri këtij vendimi ku mund të ndodhë ndonjë incidentë, sepse qytetaret nuk janë rehat në shtëpitë e tyre nga zhurma.

Migjen Kolshi: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Unë Nënkyetarit të Komunës dhe Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, ju uroi punë të mbarë dhe suksese në detyrat e reja. Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit e kam një pyetje, pse nuk është hapur konkursi publikë për parashkollorë në fshatin Harilaç, ku edhe në fshatrat me numër më të vogël të fëmijëve Pomozotin dhe Graboc i Poshtëm ato janë hapur, kjo punë është premtuar dhe nuk është realizuar nga Ish-Nënkyetari i Komunës, po ashtu edhe renovimi i shkollave që ka filluar po bëhet në mënyrë urgjente. Te lagjja e shtëpive tek 'British Home' dhe te 'Kompleksi 300' në Fushë-Kosovë, janë disa garazha që e kanë devijuar edhe rrjedhën e përrockës atje, unë kërkoj që nëse ato garazha janë në pronën publike, prona të lirohet për interesin e publikut, e jo të shfrytëzohet për të mirën e njerëzve të caktuar. Unë e pyes Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, që është lavdëruar kur Klubi i Futbollit 'Fushë-Kosova' është inkuadruar në Superligë, se si po e ndien vetën, kur klubi ynë i futbollit ndeshjet e futbollit po i zhvillon tani në qytetin e Lipjanit, është lidhur një kontratë në vlerë prej: 75,000.00€, ku komuna jonë ka participuar me një shumë të mjeteve financiare prej: 20,000.00€ dhe ato investime nuk janë kryerë në rregullimin e Stadiumit të qytetit tonë, ndërsa keni ndarë mjete financiare për ndërtim të shtëpisë në Komunën e Suharekës, ku vetë Kryetari i Komunës së Suharekës z. Bali Muharremaj ka theksuar se kjo shtëpi, është ndërtuar në tërësi nga Komuna e Fushë-Kosovës, për familjarë të një zyrtare nga komuna jonë atje.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Edhe unë Nënkyetarit të Komunës dhe Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit i uroi punë të mbarë dhe suksese. Tani kur pritet të fillon viti shkollorë kemi disa fëmijë të komuniteteve, që e kanë braktisur shkollën dhe po punojnë nëpër semaforë, në pastrimin e makinave, janë në rrugë. Ne i kemi ndihmuar mbi dy qindë fëmijë të familjeve që gjinden nën asistencë sociale, kjo ndihmë është dhënë nga organizata 'Relief Islamic', ne si përfaqësues të komuniteteve kemi bërë shumë punë të mira për komunitetet tona, ndërsa zonjën Qëndresa Ademi, unë e kam bërë anëtare të Kuvendit të Komunës dhe nuk duhet të bëjë komente të tilla, sikur po vepron tani.

Jetmir Berisha: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Nënkyetarit të Komunës dhe Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit u uroi punë të mbarë dhe suksese në punë. Unë kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të fillon një iniciativë për rregullimin e rrugës së dëmtuar në relacionin Bardh i Madh-Graboc i Poshtëm. Nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit kërkojmë që të renovohet fusha në oborrin e shkollës 'Laura Skoti', sepse në ndërtimin e Palestrës së Sportit e kemi refuzuar. Po ashtu kërkesa jonë është që komuna të participon edhe në vendosjen e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Graboc të Poshtëm dhe sigurimin e ujit të pishëm, bashkë me lidhjen e fshatit Bardh i Madh.

Aida Alimi: Unë tani reagoi këtu ndaj deklaratës së Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, ndaj anëtares së Kuvendit të komunës znj. Qëndresa Ademi, atë këtu e kanë pruar votuesit e saj, e jo ju i nderuar, unë reagimin tim këtu e bëj si Kryesuese

e Grupit të Grave dhe kërkoi nga z. Bashkim Krasniqi, që t'i kërkon falje dhe ta tërheq fjalën e tij ofenduese.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyetjet e parashtruara këtu nga ju janë shqetësime legjitime dhe detyra tona, për të cilat na obligon Ligji për Vetëqeverisje Lokale, por duhet ta keni të qartë se komuna i ka dy organe, njëri jeni ju Kuvendi dhe tjetri sipas ligjit është Kryetari i Komunës, unë këtu nuk e përfaqësoi asnjë organ, mund të flas në cilësinë e Kryetarit të Komunës në mungesën e tij. Ndaj Kuvendit të Komunës unë do të udhëhiqem nga dy parime llogaridhënia dhe transparenca, në punën dhe aktivitetet e komunës, ju këtu i paraqitët gjashtëdhjetë e katër çështje, që as kompjuteri nuk mund t'i regjistroj, në pyetjet e juaja ka pyetje të njëjta, ka përsëritje të tyre më shumë se një herë, unë për shumë pyetje, sot këtu nuk mund të jap përgjigje në mungesë të informacioneve, por do të argumentojmë dhe monitorojmë aktivitetet e punës. Cilësia e shërbimeve publike për qytetarë mund të përmirësohet me dyzet aktivitete të planifikuara me buxhet, që do të paraqes edhe kualitetin e qeverisjes, me rreth dhjetë milion euro, ku 6.3 milion euro janë nga bartja e mjeteve financiar të pa shpenzuara, të cilat janë bartur vetëm në muajin e fundit nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Këto mjete financiar prej dhjetë milion eurove ose janë të kontraktuara, ose janë në fazën e prokurimit, ose kemi projekte në detaje për realizim. Kemi vonesa në alokimin e të hyrave vetjake, unë do të përgjigjem kur të kem informata, për pyetjet që kanë informacion tani do të përgjigjen Drejtorët e Drejtorateve Komunale. Kushtet në Sallën e Kuvendit të Komunës nuk janë të mira, kemi mjete financiare të planifikuara në Drejtorinë e Administratës për këtë punë, tani është duke u ndërtuar edhe kati i dytë i komunës, ju duhet të vendosni ku do të jetë Salla e Kuvendit të Komunës, duhet të rregullohen kushtet teknike, hapësira e punës për qasje për një punë të mirëfilltë në Kuvendin e Komunës. Mendimi im është se ju këtu keni bërë shumë komente të pa sakta dhe jashtë rendit të ditës, keni thënë shumë të pa vërteta, unë nuk mund të përgjigjem në shumicën prej tyre, sepse kam mungesë të informacionit, por ju si anëtarë të Kuvendit të Komunës, do të më keni në dispozicion brenda suazave që lejon ligji.

Drejtori për Inspektorat: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i uroi detyrën e re Nënkryetarit të Komunës dhe Drejtorit të Arsimit, të cilëve ju uroj suksese në punën e tyre. Unë për Drejtorinë e Inspektoratit, i pata katër pyetje, në lidhje me dukuritë negative afër Stadiumit të Qytetit dhe afër Stacionit Policorë, të ngritur nga anëtarja e Kuvendit të Komunës znj. Aida Alimi, ne nuk kemi kompetenca për luftimin e këtyre dukurive negative dhe prostitucionit të pretenduara, ne kemi kompetencë dhe përgjegjësi për inspektimin e lokaleve për plotësimin e kushteve teknike minimale, higjieniko-sanitare, për zhvillimin e biznesit. Dukuritë negative dhe ankesat që ju i potenconi këtu, nuk janë në kompetencën tonë. Parkingjet në lagjen e Dardanisë nuk janë në kompetencën tonë, janë punë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit. Po ashtu dua t'iu informoi për aksionet e Drejtorisë tonë në teren, që kanë filluar para dy jave, por e kemi një numër të kufizuar të punëtorëve fizik në dispozicion, për këto aktivitete tona do të keni edhe njoftime në ueb-faqën e komunës. Lidhur me rrugën '17 Shkurti', ne i largojmë taksitë ilegal nga ai lokacion këtë mund të dëshmojmë edhe me fotografi, nga ortofoto dhe gjeoportali, po i dënojmë ata, por ata prapë

po dalin aty kohë pas kohë, ne kërkojmë informata nga ju për probleme të ndryshme, në mënyrë që t'i trajtojmë ato në mënyrën e duhur dhe efektive.

Drejtori për Arsimit: Renovimin e objekteve shkollore jemi duke e monitoruar në vazhdimësi me Nënkyetarin e Komunës, tani jemi në fazën e kryerjes së punimeve për renovimin e dy objekteve shkollore në qytetin e Fushë-Kosovës dhe shtatë objekteve shkollore nëpër fshatra, nga informatat që i kemi nga terreni të gjitha shkollat, do të hapen nesër, renovimet do të përfundojnë deri ditën e diele, nuk janë të rregulluara ende banjot në disa shkolla, por ato nuk do të shfrytëzohen ditën e nesërme, ashtu është gjendja në shkollën 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë dhe shkollën 'Zenel Salihu' në fshatin Bardh i Madh, që u cekë saktë nga anëtar i Kuvendit të Komunës z. Mirsad Qyqalla, kjo situatë ka ndodhur për arsye se Kompania punëkryese, e ka filluar punën nëpër shkolla vetëm para një muaj e gjysëm. Lidhur me ndihmën për studentët, pra studentin nga fshati Bardh i Madh, sikur e verifikuam tani Komisioni e respektuar në plotëni thirrjen publike, një aplikues ka mundësi ta ndërron adresën e vendbanimit nga një komunë në tjetrën vetën për pesëmbëdhjetë minuta, rasti në fjalë është banorë i Komunës së Prishtinës dhe nuk i ka plotësuar kriteret për vendbanim. Tani dua të ju informoi se në shkollën 'Mihal Grameno' janë katërmëdhjetë klasë në ndërrimin e pasdites, klasët e teta dhe të nënta, do të vendosen në Shkollën e Mesme të Lartë 'Hivzi Sulejmani' dhe procesin mësimorë e mbarojnë në orën 18:15 minuta, ndërsa nxënësit në shkollën 'Mihal Grameno' në orën 18:10 minuta, atje nxënësit janë të vendosur sipas sistemit të zonimit të nxënësve, në shkollat e qytetit tonë, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga Këshilli i prindërve, edhe koha ndërmjet ndërrimeve është e rregulluar dhe zgjatë në shumicën e rasteve pesë minuta. Sipas kontratës renovimi i shkollave nuk i plotë, por vetëm ashtu sikur është e kontraktuar të bëhet, pra vetëm ngjyrosja e shkollave në fshatin Harilaç dhe Miradi e Epërme. Sigurimi në shkolla do të bëhet në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ku kemi edhe policë civil, që e vëzhgojnë situatën në afërsi të shkollave tona.

Remzi Shala: Lidhur me çështjen e ngritur për fushën e shëndetësisë, në Qendrën tonë shëndetësore, aktualisht nuk është në funksion laborator, këtë punë e kemi adresuar, por procedurat e prokurimit kanë dështuar, ne i kemi dy ekupe të punës për teren dhe një ekip i tretë mirret me raste.

Koha e pushimit në kohëzgjatje prej 40 minutave.

Pika e tretë (3) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për norma të reja në Arsim.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për norma të reja në Arsim', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori për Arsim: Tani unë këtu do të flas për të dy pikat propozimin dhe informatën, andaj dua të them para juve se në 'Informatën për punën e Drejtorisë së Arsimit', e keni të përshkruar një strukturë të gjerë të informative, të cilat i kam sqaruar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, andaj nuk dua të përsëritem, aty e keni suksesin për vitin shkollore 2022/2023, rezultatet e testit të arritshmërisë që ka qenë 78%, ku të testuarit kanë

marrë mbi 50 pikë, edhe informata tjera i keni të përshkruara në formën narrative dhe tabelare. Ne i kemi 600 nxënës të ri, për arsye të specifikave në qytetin e Fushë-Kosovës dhe migrimit të madh tek ne për vite me radhë, andaj kemi nevojë për njëzet e katër norma të reja në arsim, i kërkojmë dhjetë norma për mësimin klasorë, prej tyre pesë në shkollën 'Mihal Grameno', tre në shkollën 'Daut Bogujevci' dhe dy në 'Aneksin 1', ndërsa katërmëdhjetë norma për mësimdhënës i kërkojmë për mësimin lëndorë nga klasa e gjashtë deri në të nëntën, po ashtu dua të ju sqaroj se me këto mjete financiare në shumën prej: 169,000.00E, parashihen edhe pagesat e tatimeve dhe ndalesat për pension në trustin e kursimeve, është i kalkuluar, edhe shpenzimi i këtyre mjeteve financiare, shpenzimet janë të planifikuara për katër muaj të këtij viti buxhetorë dhe tetë muaj të vitit të ardhshëm, pra për një vitë shkollorë që duhet të realizohet në dy vite buxhetore. Jemi në proces të renovimit të nëntë shkollave, dy në qytet dhe shtatë në fshatra, në shkollën 'Mihal Grameno', janë tetëmbëdhjetë klasë mësimi, renovimi po bëhet sipas përshkrimit në kontratën e komunës me kompaninë punë kryese, për të cilën unë jam i njoftuar tani pas marrjes së detyrës, në kuadër të procesit të dixhitalizimit që është një koncept i gjerë, kemi furnizuar me tre qind lloptopë, projektorë dhe perde statike, pra pajisje elektronike për punë për 95% të klasave, në kuadër të këtyre punëve nëntëdhjetë e tetë hapësira janë të mbuluara me kamera në shkollat tona. Janë rekrutuar gjithsej dyzet e një nëpunës në arsim, ku hyn edhe zëvendësimet, për të cilat kemi mbulueshmëri buxhetore dhe ata i kanë lidhur kontratat e punës, për ndihmat momentale, secili rastë është trajtuar nga Komisioni përkatës, puna e të cilit është mbështetur në kriteret e shpallura paraprakishtë në ueb-faqën e komunës, këto kriteret janë respektuar, mirëpo nëse dikush ka ankesa, ne do të bëjmë shqyrtimin e tyre, për të adresuar secilën shkelje eventuale nëse ka patur.

Remzi Shala: Diskutimin për normat e reja në arsim, ne nuk e kemi për herë të parë, këtë punë e kemi të trashëguar nga viti në vitë, për arsye të migrimit të madh të popullsisë në qytetin tonë, mbështetur në faktet specifike që i kemi në komunën tonë, andaj në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për njëzet e katër norma të reja në arsim për vitin shkollorë 2023-2024'. Edhe nga informata e arsimit, ne e shohim se kemi shumë sfida në arsim, njësoi është gjendja edhe në shëndetësi, i falënderojmë të gjithë kolegët e Kuvendit, qoftë nga pozita dhe opozita, që secilën herë e kanë përkrahur zgjidhjen e problemeve për personel në arsim dhe shëndetësi, po është e vërtetë është se kemi nevoja të veçanta për shërbime në këto dy fusha, po bëhen edhe ndërtime kolektive të cilat krijojnë kushte për ardhjen e banorëve të ri, që e rrisin numrin e shërbimeve. Renovimi i disa shkollave po bëhet tani, kjo punë është e planifikuara me buxhet për këtë vitë, po ashtu ne kërkojmë që të bëhet edhe rregullimi i Sallave të Sportit për t'i shërbyer ato nxënësve dhe sportistëve të secilit vendbanim, ku ato janë ndërtuar.

Durim Hajra: U përmend këtu arsimi dhe shëndetësia, ne e kemi thënë se duhet të kemi kujdes me infrastrukturën përcjellëse sociale, kur i japim lejet e ndërtimit, andaj tani si rezultat i punës jo të mirë, e kemi këtë gjendje të keqe dhe kjo punë po na përcjellë neve në dhjetë vitet e fundit. Unë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kam kërkuar që ta përgatitni një propozim-vendim si duhet, e jo në formën sikur e ka dorëzuar për shqyrtim

Drejtoria e Arsimit, ku propozim nuk ka bazë ligjore dhe mund të na kthehet në rishqyrtim nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, unë po habitem si po kërkon në këtë mënyrë ta përkrahim një propozim të paligjshëm, kur vitin e kaluar janë lejuar gjithsej 156 norma të reja në arsim. Ju duhet të komunikoni brenda institucionit me Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Arsimit, ky komunikim po mungon edhe në kuadër të Komunës së Fushë-Kosovës. Arsimi dhe shëndetësia tek ne janë para kolapsit, kur jipen lejet e ndërtimit, duhet të mendohet edhe për gjeneratat e reja, barra e përgjegjësisë këtu është e komunës, sepse ju e keni hartuar dhe miratuar Hartën Zonale të Komunës, para Planit Zhvillimor Komunal. Nesër fillon viti i ri shkollorë dhe ju e keni patur buxhetin e planifikuar për renovimin e shkollave, por këtë renovim e keni filluar me vonesë dhe shkollat nuk janë gati për fillimin e rregullt të procesit mësimorë, sepse në shkolla është duke u punuar pikërisht tani nga kompania punëkryese.

Mirsad Qyqalla: Unë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kam kërkuar sqarime ligjore, për bazën ligjore të propozimit të Drejtorisë së Arsimit, në mënyrë që ky vendim të mos na kthehet si vendim i paligjshëm, sikur na ka ndodhur edhe me shumë vendime tjera të Kuvendit të Komunës. Nevoja për personel arsimorë po shihet se ekziston, por ne vitin e kaluar i kemi patur të lejuar për buxhetin e vitit 2023, gjithsej 156 norma të reja, neve po na përcjellë një trendë i marrjes së vendimeve të tilla për rritjen e personelit arsimorë, si pjesë e zgjidhjes së përkohshme të problemit, fëmijët e kanë vendin në shkollë, atyre duhet t'iu krijohen kushte dhe hapësira për mësim dhe mësues, por gjeneza e këtij problemi vjen nga ndërtimet e shumta, të cilat nuk janë përcjellë me objekte shkollore, unë dua ta kem të qartë cili është faji ynë këtu, nëse ky vendim kthehet si i kundërligjshëm, për arsye të fajit të Ekzekutivit të Komunës, unë për hirë të nxënësve, do të jem pjesëmarrës në aprovimin e këtij vendimi, duke e ditur se po e marrim një vendim të paligjshëm, sepse për nxënësit duhet të kujdesen pushteti qendrorë dhe pushteti lokal, andaj unë kërkoj nga ju i nderuari z. Nënkryetar i Komunës, që të punoni me institucionet qendrore për zgjidhjen e këtyre problemeve në mënyrë institucionale, por duke filluar nga struktura bazike për zgjidhjen e problemeve në arsim dhe shëndetësi.

Hasan Ismajli: I nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, gjendja në arsim, shëndetësi, kulturë, rini dhe sport është e ndjeshme, punëtorët në arsim te ne janë të domosdoshëm për arsye të rritjes së numrit të popullsisë, që është duke ndodhur çdo vitë nga migrimi i madh në qytetin tonë, me këto vendime ne sunojmë të arrijmë zgjidhje të përkohshme, ngarkesat e mëdha që i kemi në shkollën 'Mihal Grameno' dhe 'Aneksin 1' dhe 'Aneksin 2', është tentuar të ndërtohet një shkollë e re, te Xhamia e re në rrugën 'Pajazit Islami', por kjo punë nuk bëhet pa miratimin e Planit Zhvillimor Komunal, zgjerimi i kapaciteteve të reja në ndërtime të larta, kërkon ndërtimin edhe të infrastrukturës sociale dhe infrastrukturës sipërfaqësore, rregullim të parqeve dhe hapësirave publike, krijim të kushteve për lëvizje të qytetarëve. Pëlqimet e dhëna për bonuse të ndërtimit dhe marrëveshjet e lidhura, do të trajtohen nga gjykata. Për normat e reja në arsim ka nevojë, andaj unë do ta jap votën time jashtëligjshëm, sepse nxënësit duhet ta kenë mësuesin në klasë, sepse unë jam i vetëdijshëm se i kemi edhe dyzet e pesë nxënës në një klasë, është detyrë e jona si institucion, që të gjejmë një zgjidhje, qoftë edhe të përkohshme.

Fisnik Sllamniku: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dua të kem një sqarim për zëvendësimin e orëve, ku në Komunën e Fushë-Kosovës vitin e kaluar pas grevës janë zëvendësuar ditët e humbura të mësimit, ditëve të shtuneve, mësuesit tonë kanë qenë në shkollë, njësoi nuk është vepruar në komuna tjera, këtu Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka qaluar në këtë drejtim, sepse nuk ka vepruar drejtë, andaj motivi i mësimdhënësve për zëvendësimin e orëve të humbura nuk është tani i njëjtë, sepse në Komunën e Prishtinës orët e humbura nuk janë zëvendësuar. Unë kërkoi që shkollat tona ta kenë mjeshterin e shkollës, për intervenime brenda shkollës, sikur e kanë në Komunën e Prishtinës. Viti i ri shkollorë po fillon me mungesë të ditave, po ashtu edhe mungesa e teksteve shkollore pritet të shkakton probleme, sepse ka diferenca aty ku kanë qenë njëzet e pesë nxënës, nuk kemi tekste shkollore për tri dhjetë e dy nxënës, probleme të tilla ka në fshatin Vragoli, por edhe në shkolla tjera. Zëvendësimi i kolegëve në shkollë e kërkon një bashkëpunim të ndërsjelltë, kjo ka ndodhur vitin e kaluar shkollorë, por tani nuk është i njëjti motiv tek mësimdhënësit. Mbështetur në problemet që i kemi në arsimit, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për norma të reja në arsim'.

Vlonjat Hasani: Ne drejtorit të ri të arsimit në komunën tonë, i dëshirojmë punë të mbarë dhe suksese, por kërkojmë nga ai që të mirret menjëherë me problemet e grumbulluara që kërkojnë zgjidhje, shumica e shkollave tona e kërkojnë një renovim të mirëfilltë, renovimi tani nuk është duke u realizuar si duhet, shkollat tona duhet të pajisen me kabinete të informatikës dhe shkencave tjera, në trembëdhjetë fshatra tona, i kemi njëmbëdhjetë salla të sportit jashtë përdorimit, edhe pse është ndarë buxhet për ndërtimin e tyre, në ndërtimin e këtyre sallave të sportit, ka patur keqpërdorime, në shkolla po ashtu mungojnë laboratorët, mungojnë vënia në funksion e bibliotekave dhe vendosja e librave në shkolla. Kjo informatë nëse është e saktë tregon si i kemi njëzet institucione private parashkollore, është një nivel i kënaqshëm i tyre, por prindërit po kanë ankesa për trajtimin e fëmijëve të tyre, në këto ankesa i kemi pranuar nga qytetarët. Ju mund t'i përdorni edhe rekomandimet e dhëna nga ana e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, aty keni shumë të dhëna që mund të ju shërbejnë në punën tuaj. Lidhur me ndarjen e subvencioneve në arsim, u tha se studentët pas aplikimit mund ta ndërrojnë vendbanimin e tyre për pesëmbëdhjetë minuta, kjo duhet të ndërlidhet me numrin e banorëve rezidentë, për të cilët jemi të obliguar të ofrojmë shërbime.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për njëzet e katër norma të reja në Arsim'

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës më shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 169,344.00€ për njëzet e katër norma të reja në Arsim' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 858, të datës 22.08.2023, për lejimin e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej: 169,344.00€ nga buxheti i komunës, për rritjen e njëzet e katër (24) normave të reja, për mësimdhënës në vitin shkollorë 2023-2024.

2. Shuma e mjeteve financiare të lejuara nga buxheti i komunës, në pikën një të vendimit, do të shfrytëzohen për pagesat e njëzet e katër (24) normave të reja për mësimdhënës, për periudhën njëvjeçare shtator 2023 - gusht 2024.

Pika e katërt (4) - Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sqaroi se 'Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024 dhe çështjet e tjera nga fusha e arsimit' u diskutuan bashkë me pikën e tretë.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e dytë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në prapë në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027', pas plotësimit të tij dhe ndjekjes së procedurave të kërkuara nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, ftoi Zyrtarin e Lartë për Mjedis që të na jap sqarime.

Adnan Bullatovci - Zyrtar i Lartë për Mjedis: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Pas njoftimit të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, ne i kemi ndjekur procedurën e kërkuar, e kemi rregulluar dokumentin në fjalë, secilin ndryshim e keni të sqaruar në material, andaj nëse nuk keni ndonjë kërkesë apo propozim ju ftoi që ta miratoni këtë plan.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për miratim me plotësime 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e miraton në shqyrtimin e dytë 'plotësime 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027.
2. Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027, i cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e veprimit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Subvencione.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtim 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Subvencione', ku sipas rekomandimit të dalur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa jemi pajtuar që pjesëmarrës në këtë Grup Punues të jenë edhe përfaqësuesit e subjekteve politike, që e kanë nga një anëtarë në Kuvendin e Komunës. Hap diskutimin.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Subvencione, i propozojmë z. Remzi Shala dhe z. Krenar Dumani.

Doruntina Jashari: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtar të Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Subvencione, e propozoi z. Durim Hajra.

Aida Alimi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, për anëtar të Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Subvencione, i propozoi z. Migjen Kolshi. Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Subvencione', në përbërje si vijon: Remzi Shala, Krenar Dumani, Durim Hajra, Migjen Kolshi, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli, Bashkim Krasniqi, Artan Asllani, Radoman Doderovic, ndërsa prej Ekzekutivit të Komunës: Besnik Osmani, Mimoza Kolshi, Mehmet Gërguri, Besnik Shala, Fatlum Berisha dhe nga Shoqëria Civile Xhevdet Qiriqi.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Subvencione', në përbërje si vijon: Remzi Shala, Krenar Dumani, Durim Hajra, Migjen Kolshi, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli, Bashkim Krasniqi, Artan Asllani, Radoman Doderovic, ndërsa prej Ekzekutivit të Komunës: Besnik Osmani, Mimoza Kolshi, Mehmet Gërguri, Besnik Shala, Fatlum Berisha dhe nga Shoqëria Civile Xhevdet Qiriqi dhe mori:

V E N D I M

Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregulloreve Komunale për subvencione, në përbërje prej gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë, nga Kuvendi i Komunës: Remzi Shala, Krenar Dumani, Durim Hajra, Migjen Kolshi, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli, Bashkim Krasniqi, Artan Asllani, Radoman Doderovic, ndërsa prej Ekzekutivit të Komunës: Besnik Osmani, Mimoza Kolshi, Mehmet Gërguri, Besnik Shala, Fatlum Berisha dhe nga Shoqëria Civile Xhevdet Qiriqi.

Pika e shtatë (7) - Rishqyrtimi i vendimit me Nr. 137, të datës 07.06.2023.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ky vendim është marrë në muajin maj 2023, është kthyer në rishqyrtim tre ditë para mbledhjes së muajit qershor, në muajin korrik nuk kemi mbajtur mbledhje të rregulltë, unë lidhur me këtë punë, i kam shkruar një shkresë zyrtare Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, se këtë vendim do ta trajtojmë në mbledhjen e parë të radhës së Kuvendit të Komunës, ky vendim nuk është zbatuar, andaj sot e kemi në rishqyrtim. Hap diskutimin.

Remzi Shala: Ky vendim nuk ka asnjë implikim në teren, mundësia e ndërtimit të lagjeve të reja, do të lejohet me përfshirjen e kësaj zone në Planin Zhvillimor Komunal, i cili është në procedurën e përgatitjes së tij, andaj ne në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk do të marrim pjesë në votim.

Durim Hajra: Unë po habitem se ju po tentoni të lëni në fuqi një vendim të kundërligjshëm, duke e ndërlidhur këtë me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, e keni me bold të shënuar, se vendimi është i kundërligjshëm dhe kjo punë është gabim, ju edhe përkundër vonesës mbi tri dhjetë ditë nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të cilën e sqaroi ai, të nderuar kolegë, ky vendim duhet të shfuqizohet.

Mirsad Qyqalla: Unë e kam dëgjuar me vëmendje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, sqarimin ligjorë të shkresës së Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ky vendim duhet të shfuqizohet, kësaj zonë mund të ndryshohet destinimi, por vetëm me Planin Zhvillimor Komunal.

Hasan Ismajli: Unë në këtë foltore e kam sqaruar këtë punë, kur e kemi shqyrtuar këtë propozim, kam thënë se është i kundëligjshëm, por ju me lënien në fuqi të këtyre vendimeve, do t'i vendosni në gjendje të vështirë pa të drejtë zyrtarët në Drejtorinë e Planifikimit Urban, sepse menaxhmenti do t'iu thotë atyre se vendimi është në fuqi dhe ata do të kenë presion për ta zbatuar. Unë jam që të ndërtohen këto lagje të reja, por kjo punë të bëhet vetëm me miratimin e Planit Zhvillimor Komunal, pastaj duhet të revidojmë Hartën Zonale të Komunës, pas të cilës nuk ka pengesa për ndërtimin e këtyre lagjeve dhe asnjë zyrtarë komunal, nuk do të ndiqet penalishtë. Edhe 'Rregullorja për bonuse të zonimit' nuk është shfuqizuar për një vitë dhe zyrtarët po kanë probleme dhe presion, ata çdo ditë janë në tension.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 137, të datës 06.07.2023, për shndërrimin e zonës bujqësore në zonë ndërtimore në fshatin Miradi e Epërme, për ndërtimin e lagjeve të reja'.

U votua me: nëntë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej nëntë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstaton, se në mungesë të votave, ky vendim mbetet në fuqi.

Pika e tetë (8) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që ta marrin fjalën nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Hasan Ismajli: Unë kërkoi nga Ekzekutivi i Komunës dhe ju i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, që vendimin e Kuvendit të Komunës për të ndihmuar qytetarët e prekur nga Covid - 19, meqë nuk është realizuar, ai duhet të shfuqizohet, në mënyrë që qytetarët të mos vendosen në lajthitje, se do të përkrahen në mbulimin e shpenzimeve në shumën prej një qindë euro nga komuna. Ka patur raste kur familje të caktuar në kohën e pandemisë kanë patur shpenzime të mëdha, andaj është marre që ata të mashtrohen, se do të përkrahen, e vendimi i Kuvendit të Komunës të mos zbatohet, andaj unë kërkoi që në mbledhjen e radhës ky vendim të shfuqizohet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Këtë vendim nëse nuk është zbatuar, duhet ta bjen për ta shfuqizuar apo ndryshuar Ekzekutivi i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:35 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

